

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI DHUNËN NË FAMILJE

Dhuna në familje është një problem i përhapur social, shëndetësor global, që kapërcen kufijtë dhe ndodh në të gjitha kulturat dhe shoqëritë anembanë botës.

Është një fenomen që ndikon negativisht në integritetin fizik, psikologjik, ekonomik dhe social, sidomos të pjesës më të ndjeshme të shoqërisë: grave, fëmijëve dhe të moshuarve.

Megjithatë, shqiptarët priren ta konsiderojnë dhunën në familje si një çështje private, familjare, dhe si një pjesë normale të jetës bashkëshortore e familjare. Duke qenë se dhuna në familje shpesh ndodh pas dyerve të mbyllura dhe nuk diskutohet, pranohet apo trajtohet hapur në shoqërinë shqiptare, viktimat përgjithësisht vuajnë në heshtje.

Nisur nga përmasat e këtij fenomeni, ndikimi që ka në shoqëri dhe marrëdhëniet specifike që cenohen, është e nevojshme angazhimi i shumë institucioneve shtetërore, përfshi dhe Policinë dhe organizatave ndërkombëtare dhe vendase.

Më shumë se sa policor, ky fenomen shfaqet si një reflektim i problemeve sociale të shoqërisë. Megjithatë roli i policisë në trajtimin e këtyre rasteve është shumë i rëndësishëm.

Nisur nga fakti se dhuna në familje gjithmonë ka qenë një fenomen shumë shqetësues, studiuesit janë përpjekur të studiojnë shkaqet dhe pasojat, me qëllim parandalimin apo minimizimin e saj.

Shpesh thuhet se Kanuni dhe zakonet janë burimi kryesor për dhunën që ushtrohet në familje dhe pozitën e diskriminuar të grave në shoqërinë shqiptare. Po a është ky argumenti i vetëm, i rëndësishëm që justifikon diskriminimin dhe dhunën në familje?

Kanuni është një nga faktorët, me të cilin spekulohet. Ka një mori faktorësh të tjerë që e kanë bërë dhunën në familje një plagë të vërtetë të shoqërisë shqiptare, të tillë si ndikimi kulturor mbështetur në traditat e vjetra patriarkale, diskriminimi gjinor, kodi i moralit dhe nderit, papunësia, kontrolli ndër-breznor në familje, situatat ekonomike e sociale të vështira, përdorimi abuziv i alkoolit dhe drogës etj.

Në mos-raportimin apo raportimin e ulët të dhunës në familje, në vendin tonë vlerësohet të ndikojnë faktorë të tillë si turpi, frika nga ndëshkimi, normat kulturore, stereotipet që ekzistojnë për dhunën në familje, varësia ekonomike etj.